

VENDIM
Nr.421, datë 27.5.2020

**PËR SHPËRBLIMIN E PUNËS PËR ANËTARËT DHE SUBJEKTET JOANËTARE
TË GRUPIT NEGOCIATOR PËR ZHVILLIMIN E NEGOCIATAVE TË ADERIMIT
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN, SI DHE TË
FUNKSIONARËVE TË KABINETIT TË KRYENEGOCIATORIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr.10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen, si më poshtë vijon:
 - a) Kryenegociatori;
 - b) Funkionarët e kabinetit të Kryenegociatorit;
 - c) Subjektet joanëtare të grupit negociator.
 2. Nivelet e pagave për Kryenegociatorin dhe funksionarët e kabinetit të tij janë, si më poshtë vijon:
 - a) Kryenegociatori barazohet në pagë me ministrin;
 - b) Drejtori i kabinetit të Kryenegociatorit barazohet në pagë me pozicionin “drejtor i kabinetit të ministrit”;
 - c) Këshilltari në kabinetin e Kryenegociatorit barazohet në pagë me pozicionin “këshilltar i ministrit”;
 - ç) Sekretari i Kryenegociatorit barazohet në pagë me pozicionin “sekretar i ministrit”.
 3. Subjektet joanëtare të grupit negociator, të cilët kryejnë detyra të ngarkuara nga Kryenegociatori, përfitojnë një pagesë në masën 6 000 (gjashtë mijë) lekë për çdo ditë pune, e cila paguhet pas realizimit të punës së ngarkuar.
 4. Për përfitimin e pagesës së përcaktuar sipas pikës 3, të këtij vendimi, subjekti joanëtar i grupit negociator i bashkëlidh raportit të tij për punën e kryer formularin e kohëzgjatjes së punës, të hartuar në përputhje me lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Formulari i kohëzgjatjes së punës miratohet nga Kryenegociatori.
 5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2020, të përballohen nga buxheti i miratuar për Kryeministrinë për këtë vit.
 6. Ngarkohet Kryeministria për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

FORMULAR I KOHËZGJATJES SË PUNËS
SË SUBJEKTEVE JOANËTARE TE GRUPIT NEGOCIATOR

Emri i subjektit:			
Detyra që i është ngarkur/kapitulli në kuadër të të cilit është kjo detyrë:			
Muaji			Viti:
Data	Dita e Punës	Përshkrimi i aktivitetit, rezultateve të arritura, materialeve të prodhuara ¹	
Total			
Shpërblimi: _____ ditë pune X 6.000 lekë = _____ lekë			
_____ (Data) (emër, mbiemër, firmë e subjektit)		_____ (Data) (emër, mbiemër, firmë e Kryenegociatorit)	

¹ Plotësimi i kësaj kolone duhet të jetë në përputhje me raportin tremujor të cilit i bashkëlidhet ky formular, duke iu referuar përshkrimit të aktiviteteve, rezultateve dhe materialeve në raportin tremujor.